



[Handwritten signature and date]

NR. 206 REP.
NR. 97 KOL.

DEKLARATË NOTERIALE

Në Tiranë, sot më datë 27.01.2020 (dy mijë e njëzet), para meje noteres Eriketa KOKOLI, me adresë në Rr. "Sami Frashëri", Pallati i Ri pranë Drejtorisë së Policisë, Kati IV, Tiranë, anëtare e Dhomës së Noterëve Tiranë, u paraqit:

DEKLARUESI: "BANKA e TIRANËS" SH.A, regjistruar si person juridik shqiptar me Vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë Nr.12718, datë 03.11.1995, NIPT Nr.J61924008V, që vepron si BANKE me Licensën Nr.07, datë 12.09.1996 të lëshuar nga Banka e Shqipërisë, me seli në Rr. "Ibrahim Rugova", Tiranë, përfaqësuar nga **Drejtores e Departamentit të Rekuperimit të Kredive Biznes, Anduela RABAJ (GJONI)**, e bija e Dashnorit, lindur më 12.02.1981 në Kuçovë dhe banuese në adresën Rr. "Medar Shtylla", Pall. i ndërtuar nga Shoqëria "2T" sh.p.k, Apartamenti Nr.11, Tiranë, mbajtëse e Letërnjoftimit Nr.032070049 dhe nga **Drejtores e Departamentit të Administrimit të Kredive, Aida CENGU**, e bija e Azemit, lindur më 16.02.1970 në Kukës dhe banuese në adresën Rr. "M. Fortuzi", Nd.2, H.14, Ap.3, Tiranë, mbajtëse e Letërnjoftimit Nr.035236532, të dyja madhore e me zotësi të plotë juridike për të vepruar, të cilët deklaruan sa më poshtë vijon:

Shoqëria "BANKA e TIRANËS" Sh.A., i ka akorduar z. Alban XHAFERI, kredinë e mëposhtme:

- Kontratë Kredie Bankare Nr.CO.632/16.04.2013 (ndryshuar me Shtojcat përkatëse), për shumën fillestare 1,000,000 EURO (një milion euro).

Për të siguruar shlyerjen e kësaj kredie, Shoqëria "AL & GI" sh.p.k, ka vendosur peng në favor të "BANKA e TIRANËS" SH.A., 111,055 (njëqind e njëmbëdhjetë mijë e pesëdhjetë e pesë) aksione të regjistruara me një vlerë nominale 1,000 Lekë (një mijë lekë) secila të zotëruara prej tij në kapitalin aksioner të shoqërisë "BIRRA TIRANA" SH.A., që përfaqësojnë 10% të kapitalit të paguar të kësaj shoqërie. Kjo vërtetohet me:

- Marrëveshjen Siguruese Nr.956Rep/Nr.522Kol, datë 19.04.2013, redaktuar nga Notere Eriketa KOKOLI.

[Handwritten signature]

[Handwritten signature]

[Handwritten signature]

Duke qenë se aksionet e Shoqërisë "AL & GI" sh.p.k, janë vënë peng në favor të "BANKA e TIRANËS" SH.A., si dhe në kushtet kur kredia e dhënë, është shlyer plotësisht, me këtë deklaratë autorizojmë Qendrën e Regjistrimit të Aksioneve dhe Qendrën Kombëtare të Biznesit, të kryejnë veprimet e nevojshme për lirimin nga pengu të 111,055 (njëqind e njëmbëdhjetë mijë e pesëdhjetë e pesë) aksioneve të zotëruara nga Shoqëria "AL & GI" sh.p.k në kapitalin aksioner të shoqërisë "BIRRA TIRANA" SH.A. dhe të vendosura peng i radhës së parë në favor të "BANKA e TIRANËS" SH.A., sipas Marrëveshjes Siguruese Nr.956Rep/Nr.522Kol, datë 19.04.2013 redaktuar nga Notere Eriketa Kokoli.

Kjo Deklaratë Noteriale u përpilua nga unë Noteri në 5 (pesë) origjinale konform vullnetit të lirë të Deklaruesve, të cilëve pasi ju lexua me zë të lartë dhe pasi e gjetën sipas vullnetit të tyre, e nënshkruan rregullisht para meje NOTERIT.

DEKLARUES
"BANKA e TIRANËS" SH.A.
përfaqësuar nga:

Andreas Robert Gjoni
Drejtores e Departamentit të Rekuperimit të Kredive Biznes

Ardo Arago Aliu
Drejtores e Departamentit të Administrimit të Kredive

NOTERE
ERIKETA KOKOLI

Eriketa Kokoli

Eriketa Kokoli



AS